



Bazuar në Ligjin nr. 03/L-175 për Borxhet Publike, Neni 7, paragrafi 2.1 dhe 2.2, Rregulloren QRK Nr. 12/2017 për Shitjen me Pakicë të Obligacioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimit të Qeverisë me nr. 20/16, Vendimit të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve me nr. 37.2021 dhe Memorandumit për Bashkëpunim në mes të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankave Komerciale/Partnere, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve shpall shitjen e obligacioneve të titulluar:

“Bono për Diasporën”

Emetuesi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Thesarit të Kosovës;

Shuma e Ofruar për Shitje: 20 milionë euro, me të drejtë të rritjes deri në 50% të shumës së ofruar;

Shitësit e Autorizuar: Bankat komerciale të licencuara si Akterë Primarë dhe nënshkruese të Memorandumit për Bashkëpunim, si në vijim: Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, NLB Banka, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank;

Periudha e Shitjes: 21 korrik 2021 - 18 gusht 2021;

Data e Emetimit: 20 gusht 2021 (T+2);

Pagesa e Interesit: Datat e pagesës janë me 20 shkurt dhe 20 gusht të çdo viti deri në përfundimin e investimit. Kuponi i parë i interesit paguhet me 20 shkurt 2022, dhe pagesat tjera të kuponëve bëhen çdo 6 muaj, në llogarinë bankare të investitorit;

Vlera Nominale: Shitja bëhet në vlerë nominale 100% të çmimit, pa premium/zbritje;

Blerja: Lejohet për të gjithë personat fizikë, rezidentë dhe jo-rezidentë;

Urdhrat për Blerje: Shuma minimale për blerje është 10,000 euro, me rritje nga 10,000 euro, kurse shuma maksimale për një person në një bankë është 500,000 euro. Urdhrat pranohen sipas radhës së dorëzimit, deri në përmbushjen e shumës së ofruar;

Kthimi i Investimit: 100% e shumës së investuar është e garantuar nga Republika e Kosovës;

Trajtimi Tatimor: Fitimi nga ky investim është i liruar nga tatimi;

Likuiditeti: Bonot për Diasporën janë obligacione të tregtueshme dhe mund të shiten në tregun sekondar të letrave me vlerë.

Për shitje ofrohen afatizimet si në vijim:

Lloji i instrumentit/kohëzgjatja	3 vite	5 vite
Numri identifikues	KV001RB08213	KV002RB08215
Data e emetimit	20 gusht 2021	20 gusht 2021
Data e kthimit të investimit	20 gusht 2024	20 gusht 2026
Interesi vjetor (Kuponi)	1.20%	2.20%

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës

Për:

Ahmet Ismaili

